



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:237637

Datë: 02.09.2024

Numri i dokumentit: 06111112

KA.nr.424/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arben Toska, në konfliktin administrativ të paditësit "Empreus" ShPK me NUI 810863052 dhe seli në sheshin Nëna Terezë, 22B-1 në Prishtinë, të cilin sipas prokurës e përfaqëson avokati Editon Osmani me seli në bulevardin Dëshmorët e Kombit, objekti 113, C-2, H-3, nr. 9 në Prishtinë, kundër të paditurit Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë, objekti i shqyrtimit anulimi i aktit administrativ, jashtë seancës më 2 shtator 2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Aprovohet kërkesëpadia e paditësit "Empreus" ShPK me NUI 810863052, kundër të paditurit Organi Shqyrtues i Prokurimit, anulohet vendimi OSHP: 2024/0332 dhe OSHP: 2024/0335 i datës 12.08.2024 i të paditurit dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje te i padituri, ashtu që ai në afat prej tridhjetë (30) ditëve në ri procedurë të nxjerrë akti të ri administrativ sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim.

A R S Y E T I M

I. Padia, kërkesëpadia dhe pretendimet e palëve

1. Paditësi përmes padisë së datës 29.08.2024 në këtë gjykatë ka iniciuar konfliktin administrativ me kërkesë për anulimin e vendimit OSHP: 2024/0332 dhe OSHP: 2024/0335 të datës 12.08.2024 të së Paditurit.
2. Ai në padi ka deklaruar se vendimi i goditur është rezultat i mos aplikimit ose aplikimit të gabuar të dispozitave ligjore, procedura që i ka paraprirë aktit administrativ nuk është zhvilluar sipas rregullave të procedurës, si dhe nuk është vërtetuar drejtë gjendja faktike. Sipas tij, i Padituri ka dështuar të arsyetoj aktin e goditur në përputhje me standardet e kërkuara me nenin 48 të LPPA-së, duke mos treguar shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave e as bazën ligjore. Më tutje argumentuar se

arsyetimi i tillë e bënë vendimin konfuz dhe nuk reflekton gjendjen faktike, gjë që përbën shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj-së. Në lidhe me këtë i është referuar aktgjykimit në rastin nr. KI7S/21 të datës 18.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

3. Me padi i ka dorëzuar provat si në vijim: dosjen e tenderit për kontratën publike kornizë – furnizim me numër të prokurimit 214-23-8647-1-1-1 të datës 15.08.2023; kushtet e përgjithshme të kontratës; kushtet e veçantat të kontratës; modeli i sigurisë së ekzekutimit; njoftimet mbi vendimin e autoritetit kontraktues dhe vendimin e goditur.
4. Gjykata pas i shqyrtoi të gjitha shkresat e lëndës, si dhe pas analizimit të dispozitave juridike të cituara më poshtë, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e Paditësit është e bazuar në ligj, si dhe çështje mund të vendoset pa shqyrtim gjyqësor në bazë të nenit 35 të LKA-së.
5. Nga shkresat e lëndës rrjedhë se autoritet kontraktues Policia e Kosovës (këtu e tutje Autoriteti Kontraktues) më 26.09.2023 e ka publikuar njoftimin për kontratën B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titullin “Furnizimi me Uniforme Policore” me numër të prokurimit 214-23-8647-1-1-1. Këtë fakt gjykata e vërtetoi përmes dosjes së tenderit të cekur më lartë.
6. Në atë aktivitet të prokurimit kanë ofertuar disa operatorë ekonomik, në mesin e të cilëve edhe Paditësi. Më 26.03.2024 autoriteti kontraktues e ka publikuar njoftimin, sipas të cilit Paditësi ishte shpërblyer me kontratë në atë aktivitet të prokurimit. Këtë fakt gjykata e vërtetoi përmes njoftimit të sapo cekur.
7. Autoriteti Kontraktues më 08.04.2024 e kishte refuzuar kërkesën për rishqyrtim të dy operatorëve tjerë ekonomik dhe e kishte vërtetuar vendimin e tij. Këtë fakt gjykata e vërtetoi nga përmbajtja e vendimit të goditur.
8. Më 12.08.2024 i Padituri e kishte dhënë vendimin e goditur me shenjë OSHP: 2024/0332 dhe OSHP:2024/0335, me të cilin kishte vendosur si në vij:

*1. Aprovohet si pjesërisht e bazuar ankesa e OP “DE Kosova Textil” LLC me nr. 2024/0332, e datës 16/04/2024 dhe OE “S.M.” BI me nr. 2024/0335 e datës 17.04.2024, lidhur me vendimin e AK “Policia e Kosovës” për aktivitetin e prokurimit “Furnizimi me Uniforme Policore” me numër të prokurimit 2014-23-8647-1-1-1.*

2. Anulohet aktiviteti i prokurimit “Furnizimi me Uniforme Policore” me numër të prokurimit 2014-23-8647-1-1-1, i iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) “Policia e Kosovës”, dhe lënda kthehet në Rivlerësim, sipas arsytimit të vendimit.

3. Në afatin prej 10 ditësh, AK duhet të informojë OSHOP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mosrespektim, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë.

4. Lejohet të bëhet kthimi i tarifës së ankesave për OE ankues “DE Kosova Textil” LLC dhe “S.M.” BI, në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetit të Republikës së Kosovës.

9. I Padituri vendimin e tij e kishte arsyetuar duke sqaruar rrjedhën e procedurës, gjetjet e tij, sqarimet e ekspertit shqyrtues, deklaratimet e palëve në procedurën administrative, si dhe sqaruar se “PSH ka ardhur në përfundim që të mbështet arsyetimin e AK-së për mos anulimin e këtij aktivitetit të prokurimit”. Pavarësisht faktit se i Padituri në dispozitiv të vendimit të goditur e kishte anuluar aktivitetin e prokurimit, megjithatë në vazhdimësi të arsytimit sqaron se nuk e anulon aktivitetin e prokurimit, por rekomandon që ky aktivitet të kthehet në rivlerësim.

## II. Vlerësimi meritor i rastit

10. Gjykata pas i mori parasysh të gjitha pretendimet e ndërgjyqësve, gjendjen faktike të konstatuar, si dhe pas analizimit të dispozitave juridike të shqyrtuara më poshtë, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e Paditësit është e bazuar në ligj, rrjedhimisht akti administrativ i goditur duhet të anulohet.
11. Siç mund të vërehet nga gjetjet e gjykatës të sqaruara më lartë, i Padituri përmes pikës 2. të dispozitivit të vendimit të goditur e kishte anuluar aktivitetin e prokurimit dhe e kishte

kthyer në rivlerësim lëndën, ndërsa në arsyetim kishte sqaruar se kishte vendosur që të mos e anuloj aktivitetin e prokurimit por vetëm ta kthej lëndën në rivlerësim. Për këtë gjykatë, vendosje e tillë është e paqartë dhe nuk është në përputhje me kërkesat ligjore të nga LPPA dhe LPP.

12. Sipas nenit 47 para. 1 nënpara. 1.2 të LPPA-së “*1. Akti administrativ i shkruar përmban: (...) 1.2. pjesën urdhëruese (dispozitivin), që tregon çfarë është vendosur si dhe afatin, kushtin, detyrimin dhe shpenzimet e procedurës, nëse është i zbatueshëm. Dispozitivi mund të ndahet edhe në më shumë pika. Shpenzimet e procedurës përcaktohen në pikë të veçantë të dispozitivit*”. Siç kuptohet nga ky formulim ligjor, dispozitivi i aktit administrativ duhet të tregoj se çfarë është vendosur me atë akt, gjegjësisht duhet në mënyrë të qartë ta tregoj vullnetin e organit administrativ lidhur me çështjen administrative të shtruara para tij.
13. Në rastin konkret, nga pika 2 e dispozitivit të vendimit të goditur, nuk dihet saktësisht është se çka është vendosur: a ka vendosur i Padituri që ta anuloj aktivitetin e prokurimit apo vetëm ta kthej në rivlerësim lëndën te Autoriteti Kontraktues, pasi në njërin anë e anulon aktivitetin e prokurimit, e në anën tjetër e kthen lëndën në rivlerësim te autoriteti kontraktues. Gjykata e sheh të rëndësishme të sqaroj se, pavarësisht faktit se i Padituri në arsyetim është shprehur se nuk e ka anuluar aktivitetin e prokurimit, por vetëm e ka kthyer lëndën në rivlerësim, megjithatë sipas nenit 47 para. 1 nënpara. 2 lidhur me nenin 44 para. 1 të LPPA-së, vullneti i organit administrativ se si ka vendosur ta zgjidh çështjen administrative të shtruara para tij duhet të dihet nga pjesa urdhëruese (dispozitivi) i aktit administrativ.
14. Për më tepër, fakti se arsyetimi përmban informata mbi arsyet pse lënda është kthyer në rivlerësim, ndërsa sqaron se nuk është anuluar aktiviteti i prokurimit, e bënë vet aktin edhe më konfuz, pasi dispozitivi dhe arsyetimi janë në kundërshtim me njëri tjetrin, meqenëse i pari e anulon aktivitetin e prokurimit, ndërsa i dyti sqaron se nuk është anuluar aktiviteti i prokurimit.
15. Gjykata e sheh të arsyeshme të sqaroj se, nenit 50 i LPPA-së nuk do të mund të gjente zbatim për vendimin e goditur, meqenëse çdo ndryshim në dispozitivi të aktit administrativ, i cili do të largonte ose zëvendësonte fjalinë “*Anulohet aktiviteti i prokurimit “Furnizimi me Uniforme Policore” me numër të prokurimit 2014-23-8647-1-1-1, i iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) “Policia e Kosovës” ...*” do të paraqiste

ndërhyrje rrënjësore në aktin administrativ, meqenëse do ta ndryshonte krejtësisht natyrën e vendosjes. Rrjedhimisht, ai veprim nuk do të paraqiste korrigjim të aktit administrativ, por ndryshim esencial të vendosjes.

16. Për këto arsye, për këtë gjykatë akti administrativ i goditur nuk është hartuar sipas kërkesave ligjore të parapara me LPPA dhe si i tillë, është i paligjshëm në kuptim të nenit 47 para. 1 nënpara 1.2 lidhur me nenin 52 para. 1 nënpara. 1.4 të LPPA-së, sipas të cilit *“Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: (...) 1.4. është nxjerre në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ”*.
17. Gjykata rikujton se, ligjshmëria e aktit administrativ të kontestuar shqyrtohet nga gjykata brenda kufijve të kërkesës nga padia, por nuk obligohet nga shkaqet e padisë, siç parasheh neni 44 para. 1 i LKA-së, ndërsa për nulitetin (paligjshmërinë) e aktit administrativ gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare, siç urdhëron neni 44 para. 2 i LKA. Kjo nënkupton se, gjykata e shqyrton ligjshmërinë e aktit administrativ të goditur edhe për arsye të cilat paditësi nuk i nga ngritur para gjykatës.
18. Për këto arsye, gjykata e anuloi vendimin e goditur dhe meqenëse karakterit i çështjes konkrete është i tillë që duhet që në vend të aktit të anuluar administrativ të nxirret një tjetër, atëherë gjykata e obligoi të Paditurin si organ administrativ i shkallës së dytë që jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga data e dërgimit të këtij aktgjykimit ta nxjerr aktin e ri administrativ.
19. Gjykata vendosi që çështjen konkrete ta zgjidh pa seancë dhe pa e dërguar padinë në përgjigje, pasi vlerësoi se janë plotësuar kushtet nga neni 35 i LKA-së, sipas të cilit *“Nëse gjykata nuk e hedh poshtë padinë në bazë të paragrafit 2. të nenit 33, apo në bazë të nenit 34 të këtij ligji, kurse konstaton se akti administrativ i kontestuar përmban të meta esenciale, që e pengojnë të çmuarit e ligjshmërisë së aktit, e anulon me aktgjykim, aktin administrativ edhe pa e dërguar padinë në përgjigje.”*
20. Kështu, gjykata në rend të parë gjeti se padia është e plotë, është e kuptueshme dhe nuk ka të meta, si dhe nuk ekziston asnjëra nga shkaqet nga neni 34 të LKA-së. Në anën tjetër, siç është sqaruar më lartë, shkeljet janë esenciale që e pengojnë çmuarjen e ligjshmërisë së aktit administrativ të goditur, rrjedhimisht për këtë gjykatë nuk pati nevojë që të caktohet seancë. Në këtë drejtim, gjykata e sheh të arsyeshme të sqaroj se, vendosja e gjykatës do të ishte e njëjtë edhe po të mbahej seanca e shqyrtimit kryesor, sepse siç është

sqaruar më lartë, shkeljet ligjore lidhur me formën e aktit administrativ janë të qarta dhe të paevitueshme më vonë.

21. Përveç kësaj, siç rrjedh edhe nga vet vendimi i goditur, Autoriteti Kontraktues që nga vitit 2021 është pa kontratë të vlefshme për furnizimin me uniforma për të gjithë zyrtarët e tij. Prandaj pritja e lëndës konkrete për tu zgjidhur nga gjykata, duke e ditur paqartësinë e vendosjes së të Paditurit, gjegjësisht pa qenë e qartë se a është anuluar aktiviteti i prokurimit apo është kthyer lënda në rivlerësim, do ta zvarriste vet aktivitetin konkret të prokurimit, rrjedhimisht do ta vështirësonte tej mase punën e policisë, gjë që mund të kishte pasoja në sigurinë dhe rendin publik.
22. Për këto arsye, duke qenë se të metat e aktit administrativ të goditur janë evidente dhe nuk mund të rregullohen më vonë, gjykata vendosi që ta zgjidh çështjen jashtë seancës pa e dërguar padinë në përgjigje.

#### IV. Udhëzimet për organin administrativ në ri procedurë.

23. Në ri procedurë i Padituri duhet që të nxjerrë aktin e ri administrativ, i cili është në përputhje me kërkesat e LPPA-së lidhur me formën e aktit administrativ, si dhe kërkesat ligjore të LPP-së lidhur me kompetencat e tij për zgjidhjen e ankesës. Në këtë drejtim, ai në dispozitiv të aktit të ri administrativ duhet të bëjë të qartë se çka ka vendosur. Nëse i Padituri vendos që ta anuloj aktivitetin e prokurimit, atëherë ai duhet fjalinë në dispozitiv ta formulojë në mënyrë të qartë, të kuptueshme dhe pa lëndë dykuptimësi, ndërsa në të njëjtën kohë nuk mundet ta kthejë çështjen në rivlerësim, siç ka vendosur me vendimin e goditur. Në këtë rast, ai duhet të arsyetojë në bazë të cilave dispozita ligjore ka vendosur që ta anuloj aktivitetin e prokurimit, nga cila dispozitë ligjore rrjedh autorizimi tij që ta anuloj aktivitetin e prokurimit, nga cilat prova rezulton se janë plotësuar kushtet për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe pse vendosja ndryshe (për mos anulimin e aktivitetit të prokurimit) ka qenë e pamundshme. Në anën tjetër, nëse i Padituri vendos që ta kthejë lëndën në rivlerësim te Autoriteti Kontraktues, atëherë ai dispozitivin duhet ta formulojë në mënyrë të qartë, të kuptueshme dhe pa lënë dyshime për mënyrën e vendosjes, ndërsa në të njëjtën kohë nuk mundet ta anuloj aktivitetin e prokurimit, siç ka vendosur me vendimin e goditur. Edhe në këtë rast duhet t'i tregoj gjetjet e tij faktike, bazën juridike për vendosje, arsyet se si janë plotësuar kushtet për kthimin e lëndës në rivlerësim etj.

24. Pavarësisht udhëzimeve të cekura në pasusin e mësipërm, gjykata e sheh të rëndësishme të sqaroj se i Padituri është ligjërisht i lirë që t'i vlerësoj shkresat e lëndës administrative dhe të vendos sipas vlerësimit të tij duke u bazuar në ligj. Pra, gjykata përmes këtij aktgjykimi nuk shpreh qëndrimin e saj për meritat e rastit administrativ që është shtruar para të Paditurit, gjegjësisht udhëzimet e gjykatës nuk kanë të bëjnë me aprovimin e ankesave ose refuzimin e tyre, por vetëm jep udhëzime mbi formën e aktit administrativ, pavarësisht mënyrës së vendosjes. Pra, udhëzimet e kësaj gjykate kanë të bëjnë me të metat formale (procedurale) të aktit administrativ, ndërsa assesi nuk prekin lirinë të Paditurit lidhur me vendosjen meritore (themelësinë e ankesave).
25. Gjkata sqaron se i Padituri me rastin e nxjerrjes së aktit të ri administrativ është i obliguar nga pikëpamja juridike e gjykatës, si dhe nga vërejtjet e gjykatës lidhur me procedurën, siç e ka paraparë neni 65 i LKA-së. Gjkata sidomos rikujton se nxjerrja e vendimit të ri në kundërshtim me vërejtjet e gjykatës është bazë për fillimin e konfliktit administrativ sipas nenit 16 para. 1 nënpara. 5 i LKA-së.
26. Për arsyet e cekura më lartë, duke u bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 43 të LKA-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjkata Komerciale e Kosovës

Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.424/24

Gjyqtari

---

Arben Toska

**UDHËZIMI PËR MJETIN E GODTIJES:** Kundër këtij aktgjykimit mund të paraqitet ankesë brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit. Ankesa në formë të shkruar dhe në ekzemplarë të mjaftueshme për gjykatën dhe secilën palë tjetër dorëzohet në këtë gjykatë, ndërsa i drejtohet Dhomës së Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale.